



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:146999

Datë: 21.12.2021

Numri i dokumentit: 02536400

P. nr. 461/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit **S. Z.** nga fshati . . . Komuna Klinë, për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335/1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.778/2020 të datës 16.09.2021, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **16.12.2021**, në prani të Prokurorit së shtetit Sadri Alija, të dëmtuarit H. K. dhe të akuzuarit, me datën 17.12.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **S. Z.**, nga fsh. . . Komuna Klinë, data e lindjes . . ., biri i S. dhe i nënës Gj., e gjinisë Gashi, ka te kryer IV kl të shkollës fillore, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas R. Kosovës, i martuar atë i 1 femije, me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

-me datë të pacaktuar të muajit Dhjetor 2018, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke i fshehur ato dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, e mashtron të dëmtuarin H. K. nga fsh. . . Komuna Gjakovë, në atë mënyrë i pandehuri ka shkuar tek i dëmtuari në fshatin e tij, ka kontaktuar dhe pirë kafe dhe në bisedë e sipër mes vete i ka kërkuar S. që ti jep ndonjë veturë për ti kompensuar me punë ndërtimi, ashtu që pasi të dy merren vesh, i dëmtuari i'a jep veturën e tipit “. . .” dhe atë të tipit “. . .” në çmimin e shitjes prej 7.400 Euro ku prej tyre 2.000 euro kishte për ti paguar në dhjetorin e vitit 2018 në dorë, ndërsa shumën prej 5.400 Euro kishte për ti realizuar me punë ndërtimtarie, në këtë mënyrë i pandehuri S. me veprimet e tija të kundërligjshme arrin të vë në lajthim të dëmtuarin me çka e ka nxit të njëjtin në kryerjen e veprimit në dëm të pasurisë së tij.

-me çka ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335/1 të KPRK-së

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,46,49,50,51,52, 73, neni 335/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **4(katër) muaj**, i cili dënimi nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në shumë prej **200.00 (dyqind)-euro** ,në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në formë të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi , në kohëzgjatje prej **10(dhjetë) ditësh** , duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20(njëzet).-€**.

Në kuadër të verifikimit obligohet i akuzuari S. Z. , që në afat prej **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ta kthejë dobinë pasurore të përfituar me kryerjen e veprës penale, ashtu që t'ia kompensojë dëmin në shumën prej **7400.(shtatë mijë e katërqind) -€** të dëmtuarit H. K. nga fshati . . . Komuna Gjakovë, e në rast të mos përmbushjes së këtij obligimi do të revokohet dënimi me kusht, ashtu që i akuzuari do të vuajë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **4 (katër) muajve**.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **30.00 €**, si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20.00 €**, në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.778/2020 të datës 16.09.2021, e ka akuzuar të akuzuarin S. Z.nga fshati . . . Komuna Klinë , për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335/1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.16.12.2021, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë , Prokurori i shtetit Sadri Alija , lexoi aktakuzën PP/II.nr.778/2020 të datës 16.09.2021dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari S. Z. , lidhur me fajësinë ,thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë me pranimin e fajësisë jam përduruar për veprën e kryer, duke vepruar në kundërshtim me bisedën që e kemi pasur me të dëmtuarin pasi vërtet nuk e kam përmbushur obligimin të cilën e kam marr ,andaj i propozoi gjykatës që të marrë parash rrethanat lehtësues si pranimin e fajësisë ,premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ,kërkim falje nga i dëmtuari për veprimet e mia , gatishmërinë për kompensim të dëmit gjegjësisht borxhin që ja kam të dëmtuarit H., faktin se më parë nuk kam rënë ndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim me të butë.

I dëmtuari H. K. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i akuzuari kërkoi nga i akuzuari që i njëjti të japë dëmin e shkaktuar ku në rast të mos pagesës së dëmit brenda afatit të caktuar nga ana e gjykatës i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari Prokurori i shtetit Sadri Alija ,deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuarit S. Z. pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favorin e pranimin të fajësisë të sqaruara nga ana e gjykatës, duke marrë parasysh se aktakuza ka mbështetje në provat personale dhe materiale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohet akuzuari andaj i propozoi

gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit ndërsa si rrethanë lehtësuese i nijet të merret parasysh pranimi i fajësisë si dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari S. Z. : **-me datë të pacaktuar të muajit Dhjetor 2018**, me anë të paraqitjes së rreme të fakteve apo duke i fshehur ato dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo personin tjetër, e mashtron të dëmtuarin H. K. nga fsh. . . . Komuna Gjakovë, në atë mënyrë i pandehuri ka shkuar tek i dëmtuari në fshatin e tij, ka kontaktuar dhe pirë kafe dhe në bisedë e sipër mes vete i ka kërkuar S. që ti jep ndonjë veturë për ti kompensuar me punë ndërtimi, ashtu që pasi të dy merren vesh, i dëmtuari i'a jep veturën e tipit “. . .” dhe atë të tipit “. . .” në çmimin e shitjes prej 7.400 Euro, ku prej tyre 2.000 euro kishte për ti paguar në dhjetorin e vitit 2018 në dorë, ndërsa shumën prej 5.400 Euro kishte për ti realizuar me punë ndërtimtare, në këtë mënyrë i pandehuri S. me veprimet e tija të kundërligjshme arrin të vë në lajthim të dëmtuarin me çka e ka nxit të njëjtin në kryerjen e veprimit në dëm të pasurisë së tij. **-me çka ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335/1 të KPRK-së**

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese konsideron faktin se i njëjti ka kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par.1 të KPRK-së , ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarit se i njëjti është baba i një fëmije , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës , pendimin e tij dhe premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet në të ardhmen , sjellja korrekte në gjykim , i vetëdijshtëm për pasojat e shkaktuara ,gatishmëria për kompensimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit , faktin se i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale nëse i kompensohet dëmi , si dhe gatishmëria për kompensimin e dëmit të shkaktuar të dëmtuarit . Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **4 (katër) muaj** , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** , nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale si dhe dënim me gjobë në shume prej **200(dyqind) euro** ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën par.2.6 të KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 €, është marrë konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.464/21 më datë 17.12.2021.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë.Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2021:146999
Datë: 21.12.2021
Numri i dokumentit: 02536400